



RAPORT VJETOR

2019



Përmbajtja

<i>Zhvillimi Institucional</i>	3
<i>Misioni i Agro & Social Fund</i>	4
<i>Mesazhi i Drejtorit Ekzekutiv</i>	5
<i>Arritjet 2019</i>	6
<i>Arritjet në kredidhënie</i>	7
<i>Produktet tona të Kredisë</i>	8
<i>Sistemi i ri i kredive online</i>	10
<i>Bilanci</i>	11
<i>Pasqyra e të ardhurave</i>	12
<i>Pasqyra e flukseve të monetare</i>	13
<i>Raporti i auditoreve të pavarur</i>	15
<i>Performanca Sociale</i>	17
<i>Projekte dhe Fushata</i>	19
<i>Klientët tanë</i>	21
<i>Partnerët Tanë</i>	22

ZHVILLIMI INSTITUCIONAL

2001

Krijohet "Building Future" si program mikrofinanciar i World Vision Albania, fillimisht me hapjen e zyrës së parë në rajonin e Lezhës

2009

Kalon Institucion Mikrofinanciar me status ligjor "Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar" - Vision Fund Albania. Në pronësi dhe kontroll 100% të VisionFund International, degë e World Vision International

Dhjetor
2009

Agro & Social Fund mori licencën nga Banka e Shqipërisë Nr. 17, si Institucion Financiar i Miktokredisë

Nëntor
2016

VisionFund International vendos tërheqjen e përfunduar të tyre nga Shqipëria, kështu që në muajin dhjetor 2016, u arrit marrëveshja e shitjes së Institucionit tek Fond BESA sh.a., institucioni financiar jobankar më i madh në Shqipëri

Dhjetor
2016 e
deri tani

Fondi BESA është pronari dhe ortak i vetëm i këtij institucioni me zotërimin 100% të aksioneve

Zyrat e Agro & Social Fund:

Lezhë – që prej vitit 2001

Korçë - që prej vitit 2003

Laç - që prej vitit 2007


Librazhd - që prej vitit 2008

Elbasan - që prej vitit 2011

Tirana - që prej vitit 2018

Pogradec - që prej vitit 2018

Bilisht - që prej vitit 2018



Misioni i Agro & Social Fund

Ne mbështesim zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen financiare dhe kohezionin social, nëpërmjet asistencës së përgjegjshme financiare të ndërmarrjeve micro e të vogla kryesisht, me qëllim zvogëlimin e varfërisë, lehtësimin dhe përmirësimin e jetës në komunitete dhe zgjerimin e oportuniteteve për punësim, duke operuar kryesisht në zonat rurale e semi-urbane, por dhe ato urbane.

Vlerat e Agro & Social Fund

Agro & Social Fund është i fokusuar në përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve që i ofrohen klientelës së synuar, kryesisht nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të kërkesave të tyre, krijimit të mundësive për klientët, familjet dhe komunitetet në rritjen e mirqenies, uljen e varfërisë apo vulnerabilitetit, rritjes së aksesit në finance, krijimit të vendeve të reja të punës apo dhe shtimit të vlerës së atyre ekzistuese.

Në rrugëtimin tonë të udhëhequr nga misioni, ne ruajmë e pasurojmë **vlerat tona.**

Ne përpiqemi t'i shfrytëzojmë këto vlera me qëllimin që të sigurojmë punonjës të motivuar dhe të orientuar drejt rritjes së rezultateve dhe mbrojtjen nga devijimi i misionit, punonjës që do arrijnë të zhvillohen e veprojnë në sintoni të plotë me linjën për rritjen e objektivave të institucionit.

V Ne jemi përkushtuar për të punuar pranë njerëzve, me qëllim nxitjen e përmirësimit të jetës së tyre.

L Ne jemi besnikë ndaj qëllimit dhe të përgjegjshëm për burimet që na janë besuar, duke i menaxhuar ato në mënyrë të tillë, që të sjellin kthimin maksimal për kompaninë dhe klientët tanë.

E Ne vlerësojmë njerëzit, i konsiderojmë të barabartë dhe u japim përparësi atyre përkudrejt fitimit e qëllimeve tradicionale të biznesit, strukturave apo sistemeve.

R Ne jemi punonjës dhe një kompani e besuar në treg, ajo e cila qëndron për integritetin dhe vendos një standard për të, duke frymëzuar të tjerët të jenë gjithmonë të besueshëm dhe të ndershëm.

A Ne vlerësojmë e promovojmë transparencën dhe sjelljen etike.

Mesazhi i Drejtorit Ekzekutiv

Të nderuar,

Së bashku me ju ishim bashkëudhëtarë të një procesi rritjeje, I cili për tu përmbushur, na ballafaqoi me sfida, vështirësi, bashkëveprim të shtuar, përpjekje intensive, pengesa. Përtej tyre, me një bashkëpunim dhe bashkërendim aktiv të gjithësecilit antar të familjes sonë dhe të gjithësecilit partner, siguroam që ky proces të shkojë mbarë për ASF-në edhe për çdo kënd tjetër I cili besoi të bashkëpunojë me ne.

Dëshiroj të falenderoj çdo klient që besoi se duke bashkëpunuar me ASF-në, ka krijuar një perspektivë zhvillimi e rritjeje ekonomike për biznesin që drejton, për familjen nënkujdestari, për veten personalisht dhe për zonën ku zhvillon aktivitetin.

Dëshiroj të falenderoj donatorët dhe huadhënësit që na besuan fondet e tyre dhe vlerësuan qasjen tonë në drejtim të financimit të biznesit, transparencës, etikës, zhvillimit lokal dhe shtresave të marginalizuara.

Dëshiroj të falenderoj mbi të gjithë, antarët e famijes sonë për qasjen proaktive ndaj përmbushjes së objektivave që lidhen me performancën financiare, performancën sociale, punësimin e grave e të rinjve, reduktimin e varfërisë etj.

Gjatë vitit 2019, ASF përmirësoi strukturën e saj administrative dhe institucionale duke synuar një nivel të lartë menaxhimi në përputhje me planet afatmesme për rritje. Në të njëjtën kohë përmirësoi infrastrukturën e Zyrës Qendrore dhe rjetit të Degëve me pajisje të reja, me sistem informatik të ri, duke synuar rritjen e eficiencës dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj klientëve.

Gjatë vitit 2019, ASF siguroi tregues të kënaqshëm sa I takon portofolit të kredisë duke shënuar një rritje prej 28% krahasuar me një vit më parë dhe arritur një nivel portofoli në fund të vitit 2019 prej 643,621,577 lekë, duke ju shërbyer rreth 1776 klientëve dhe disbursuar rreth 555,075,000 lekë.



Në të njëjtën kohë ne jemi krenarë që gjatë vitit 2019 ne lehtësuam përmirësimin e cilësisë së jetës në mënyrë të drejtpërdrejtë të 215 fëmijëve dhe në mënyrë indirekte të 3,776 të tjerëve, ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës të 253 klientëve nga grupet e marginalizuara dhe ju krijuam mundësinë rreth 180 klientëve të ishin sipërmarrës të një biznesi për herë të parë, siguroam që rreth 55% e totalit të klientëve të jenë të përqëndruar në zonat rurale dhe rreth 41 % e numrit të klientëve të ishin klientë “femra”.

Së bashku me ju dëshiroj të përcjell urimin, që viti që kemi hyrë të mundësojë për të gjithë një perspektivë të sigurtë dhe të qëndrueshme, në të mirë të zhvillimit, mirëqenies dhe prosperitetit dhe njëkohësisht të risigurojw që angazhimi I ASF-së do të jetë I pandryshueshëm sa I përket parimeve që lidhen me zhvillimin lokal dhe të qëndrueshëm, uljen e varfërisë, punësimin, dhe në veçanti punësimin e të rinjvë, grave dhe shtresave të marginalizuara.

Faleminderit!

Rozana OROZI
Drejtor Ekzekutiv

Arritjet 2019



Agro & Social Fund, është Institucion Financiar Jobankë i mikrokredisë, me aktivitet të nisur në vitin 2001, si një program zhvillimi nën administrimin e World Vision Albania.

Ky subjekt në mbyllje të dekadës së dytë të aktivitetit të tij dhe si një subjekt që prej më shumë se tre vite nën administrimin e Aksionarit të ri, Fondi Besa sh.a, po ecën me një mision të qartë dhe objektiva ambiciozë.



Ky mision është i orientuar drejt zhvillimit dhe rritjes së sipërmarrjes, forcimit të karakterit social të nismave dhe duke adresuar çështje që kanë në fokus zonat rurale e gjysëm urbane kryesisht, pa neglizhuar edhe zonat urbane.

Një ekip prej 57 profesionistësh e personeli ndihmës, u shërbyen më shumë se 2,509 klientëve dhe administruan një portofol prej 643,621,577 lekë .Në shifra kumulative përgjatë këtyre viteve ju është shërbyer rreth 24,771, klientëve, duke disbursuar rreth 4,273,793,111 Lekë



Që prej muajit Tetor 2016, moment kur Agro & Social Fund kaloi nën administrimin e Aksionarit të ri, një moment i rëndësishëm për të gjithë zhvillimet strategjike të mëpastajme, ecurinë operacionale, financiare dhe sociale të organizatës, portofoli aktiv i kompanisë u rrit me 150.9% në tre vitet e fundit, respektivisht 29% në 2017, 59% në 2018 dhe rreth 28% në fund të vitit 2019.

Retention RATE (Raporti i Ruajtjes së klientelës) 70.3%

Rreth 55% e totalit të klientëve vijnë nga zona rurale dhe 41% janë kliente femra, të regjistruar në fund të 2019-s.



Nga vlerësimet, rezulton se rreth 3,776 fëmijë janë impaktuar në mënyrë direkte e indirekte nga kreditë e disbursuara përgjatë vitit 2019



E organizuar aktualisht në 4 Degë dhe 4 Nën-Degë, që operojnë të shpërndara në të gjithë territorin, arrihet të mbulohet me shërbime një pjesë e veriut, e juglindjes dhe e Shqipërisë qendrore. Me projekte të dedikuara po punohet në zona të veçanta siç është Tropoja dhe Elbasani.






Të tjera (Dhjetor 2019)

Stafi TOTAL	60	
Punonjës femra	32 nga 60	(53%)
Femra në drejtim	6 nga 10	(60%)

Arritjet në kredidhënie

- Administrimi dhe menaxhimi i fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë;
- Rritjen e volumit të kredive Aktive ne Numer me **314 kliente** dhe **140 milion** ne Vlere, respektivisht me **14%** dhe **28%**, per vitin 2019.
- Rritjen e volumit të Disbursimit ne Numer-**84 kliente** dhe **41 milion** ne Vlere krerespektivisht dhe-**4%** dhe **8%**, per vitin 2019.
- Rritjen e volumit Kumulativ ne Numer me **1776 kliente** dhe me **555 milion** neVlere respektivisht **8%** dhe **15%**, per vitin 2019.
- Analizën e kapacitetit pagues të klientëve ;
- Cilësinë e portofolit;
- Monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të kredidhënies;
- Rritja e efikasitetit të stafit kreditues në të gjitha degët e Agro & Social Fund, si dhe integrimi eficient i stafit të ri - nëpërmjet stimulimit të praktikave të bashkëpunimit dhe nxitjes së frymës së grupit (ekipit);
- Realizimi periodik i analizës së rezultateve për çdo Degë Rajonale, bazuar në realitetet respektive të çdo Dege, stafit të tyre, etj - ruajtja e afërsisë dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me punonjësit në Degë dhe stimulimi i frymës së ekipit, pavarësisht rritjes graduale të organizatës;



Produktet tona të Kredisë

SHUMA DERI NE 2,000,000 LEKE
AFATI DERI NE 84 MUAJ
INTERESI PERCAKTOHET NGA SHUMA E KREDISE

**KREDI
BIZNES - AGRO**

**KREDI
SOCIALE**

SHUMA DERI NE 500,000 LEKE
AFATI DERI NE 48 MUAJ
INTERESI PERCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISE

**KREDI
EFICENCE
ENERGJIE**

SHUMA DERI NE 1,000,000 LEKE
AFATI DERI NE 60 MUAJ
INTERESI PERCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISE

**KREDI
KONSUMATORE**

SHUMA DERI NE 300,000 LEKE
AFATI DERI NE 36 MUAJ
INTERESI PERCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISE


**KREDI
RICIKLIM**

SHUMA DERI NE 500,000 LEKE
AFATI DERI NE 48 MUAJ
INTERESI PERCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISE

**KREDI
START UP**

SHUMA DERI NE 300,000 LEKE
AFATI DERI NE 36 MUAJ
INTERESI PERCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISE

Outstanding sipas Produkteve



Biznes&Agro

Konsumatore

Eficence Energjie

Sociale

Riciklim

Start-Up

E-Housing

Projektet (Diakonia Agapes/Dorcas Trovoja)

**ANALIZA E RISKUT
ESHTE NJE PROCES
QE KA LIDHJE ME TRE
KOMPONENTE:**



Vleresimi i riskut, percakton nivelin e prezences dhe efektet te nje risku te vecante si dhe trendin e zhvillimit,menaxhimit apo kontrollin e tij.



Menaxhimi i riskut,fillon me percaktimin se cfare duam te arrijme duke kuptuar sakte faktoret e brendshem dhe te jashtem qe mund te influencojne suksesin e arritjes se ketyre objektivave.



Kontrolli i riskut-elzekutimi i strategjise se pergjigjes se riskut,monitorimit te riskut,inicimi i planeve te kontigjences dhe rishikimeve per risqe te reja.

Stafi menaxherial i ASF-se menaxhoi risqet me te cilat institucioni u perball pergjate ushtrimit te aktivitetit te tij me qellimin final te arrinte objektivat e vendosura dhe nga ortaku i vetem"Fondi Besa" dhe krijimin e nje kulture korporative te vendimarrjeve me risk te kalkuluar.

Rezultatet e Agro & Social FUND per vitin 2019, vleresohen pergjithesisht pozitivisht. Ato tregojne per nje menaxhim te mire te burimeve,ekspozimeve ndaj risqeve,perdorimit te fondeve apo trajtimit te mangesive ne momente te caktuara te vitit, si dhe ne drejtim te menaxhimit te stafit.



Risk i ASF-se per 2019 rezulton me 2.69%

Sistemi i ri i kredive online

Në vitin 2019 starton sistemi i ri i kredive online në Agro & Social Fund sh.p.k. Sistem me baze WEB, që ka 24 orë shërbim online, përditësim aktual dhe njëkohësisht pafundësi shtimi informacioni për Shoqërinë.

Të rejtat që sjell ky sistem i ri:

- ✓ garantimin e shkëmbimit të informacionit në kohë reale,
- ✓ garantimin e shkëmbimit të informacionit në mënyrë të sigurtë dhe korrekte për të gjithë punonjësit e Shoqërisë,



- ✓ sistem i integruar me programin e financës
- ✓ gjenerim i raporteve të ndryshme që i shërbejnë kompanisë për të ndjekur ecurinë e biznesit,
- ✓ përputhshmëri me standardet e raportimeve ndaj Bankës së Shqipërisë dhe Rregjistrimit të saj të Kredive,
- ✓ u realizua një prej objektivave strategjike të Shoqërisë.

(Shumat në mijë Lek)

	2019	2018
Aktivitet		
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	62,889	5,107
Hua dhe paradhënie për klientët	623,525	494,487
Aktivitet afatgjata materiale	17,814	12,333
Aktive të tjera	11,149	5,634
Të drejtat mbi Asetet	53,363	-
Totali i aktiveve	768,740	517,561
Detyrimet dhe Kapitali i vet		
Detyrimet		
Huate (AC)	437,542	-
Detyrimet mbi Qeratë	53,782	276,432
Detyrime të tjera	17,188	2,683
	508,512	279,115
Kapitali i vet		
Kapitali aksionar	289,375	289,375
Humbje të mbartura	(50,929)	(69,112)
Fitimi i vitit	21,782	24,230
	260,228	238,446
Totali i detyrimeve dhe Kapitali i vet	768,740	517,561

Pasqyra e të ardhurave

(Shumat në mijë Lek)

	2019	2018
Interesa		
Të ardhura nga interesi	159,360	118,615
Shpenzime për interesa	(28,650)	(15,339)
Të ardhura neto nga interest	130,710	103,276
Të ardhura/(Shpenzime) të tjera	(1,315)	2,946
Shpenzime operative		
Zhvlërësimi	(9,088)	(2,242)
Shpenzime personeli	(67,640)	(55,962)
Humbje nga zhvlërësimi i huave	(10,456)	(2,026)
Shpenzime të tjera	(15,002)	(18,372)
Fitim/(humbje) neto nga kurset e këmbimit	(913)	1,184
Totali i shpenzimeve operative	(103,099)	(77,418)
Fitim/(humbja) përpara tatimit	26,296	28,804
Tatim fitimi	(4,514)	(4,573)
Fitim/(humbja) për vitin	21,782	24,231
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit	-	-
Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin	21,782	24,231

Pasqyra e flukseve të monetare

((Shumat në mijë Lek)

	2019	2018
Flukset monetare nga aktivitete operacionale		
Fitimi / (Humbja) për vitin	26,296	28,803
<i>Korrigjime për:</i>		
Zhvlerësimi	3,032	2,242
Zhvlerësimi në Të drejtat mbi Asetet	6,056	-
Pakësime neto në Aktivitet Afatgjata	420	-
Humbje nga zhvlerësimi i huave	10,456	2,026
Të ardhura nga interesi	(159,360)	(118,615)
Shpenzime për interesa	28,650	15,339
<i>Ndryshime në:</i>		
Hua dhe paradhënie për klientët	(131,852)	(174,038)
Aktive të tjera	(5,175)	10,325
Detyrime të tjera	14,505	(14,221)
Flukset monetare të përdorura në aktivitete operacionale	(206,972)	(248,139)
Interesi i arkëtuar	151,717	112,382
Interesi i paguar	(28,166)	(14,319)
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	(4,853)	-

Pasqyra e flukseve të monetare

(Shumat në mijë Lek)

	2019	2018
Flukset monetare nga / (te perdorura) ne aktivite operacionale	(88,274)	(150,076)
(Shtesa)/ pakësime neto në aktivet afatgjata materiale	(8,933)	(8,564)
Flukset monetare përdorur në aktivite investuese	(8,933)	(8,564)
Flukset monetare nga aktivite financuese		
Fonde të (paguara)/ marra si hua dhe qira financiare	160,811	154,216
Pagesa në Detyrimet mbi Qeratë	(5,822)	-
Flukset monetare përdorur në aktivite financuese	154,989	154,216
Rritja/ (rënia) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to	57,782	(4,424)
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit	5,107	9,531
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit	62,889	5,107



Building a better
working world

Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUJS: K619110121
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Agro & Social Fund sh.p.k

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agro & Social Fund sh.p.k ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, si dhe të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* ("Kodi i BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri ("Kodi IEKA"), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Raporti i auditoreve të pavarur

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Agro & Social Fund sh.p.k, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri


24 Dhjetor 2020
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Auditues Ligjor





Performanca Sociale

Agro & Social Fund vlerëson, ndjek dhe synon përmiresimin e treguesve të Performancës Sociale duke respektuar përcaktimet ndërkombëtare mbi matjen dhe raportimin e tyre.

Agro & Social Fund mat dhe raporton treguesit e performances sociale për të gjithë palët e interesuara:

- Klientët, të cilët mund të jenë të shqetësuar për etikën dhe impaktin social të blerjeve e investimeve të tyre.
- Ortakët, që kërkojnë të kenë në konsideratë

impaktin social dhe rreziqet mjedisore për vendimet e tyre për investime;

- Komunitetet në të cilat operon, që kërkojnë të dinë vlerën që ne kontribuojme në shoqëri;
- Punonjësit, që duan siguri se kompania ku ata punojnë është një kompani që kujdeset për impaktin social dhe mjedisor që ka aktiviteti i saj.
- Partnerët , të cilët kërkojnë të vihen në djeni për impaktin social të projekteve të implementuara në bashkëpunim me ASF.

Impakti Social



Shërbyer 1,800 klientëve

Shërbyer 1,800 klientëve gjatë gjysmës së parë të vitit 2019 me ndihmë financiare, për të adresuar vështirësitë financiare, përmirësuar nivelin e jetesës, të ardhmen e fëmijëve dhe komuniteteve ku jetojnë



Ruajtur 1,600 vende pune

Papunesia është elementi kryesor me të cilin luftojnë shumica e vendeve në zhvillim. Agro & Social Fund kujdeset në menyrë prioritare për të kredituar biznese që shërbejnë si burim të ardhurash për më shumë se një familje.



Krijuar 125 vende pune

Agro & Social Fund synon të kontribuojë në treg duke ndihmuar në krijimin e vendeve të reja të punës. Për këtë qëllim propozoi edhe produktin e ri “Të rinjtë sipërmarrës” i ideuar për t’ju ardhur në ndihmë të rinjve që kërojnë të hapin/zhvillojnë aktivitetin e tyre.



122 sipërmarrje të reja

Sipërmarrësit e rinj kanë potencialin për të ndërtuar një ekonomi të re gjeneruese dhe punë dinamike, ndaj do të jenë gjithmonë në fokus të Agro & Social Fund për t’u mbështetur në idetë e tyre, kryesisht me produktin Start-Up.



Përmirësuar jeta e 3,500 fëmijëve

Me krenari Agro & Social Fund vazhdon të përkrah një ndër aspiratat më të ndjeshme të World Vision: “Rritjen e mirëqenies së qëndrueshme të fëmijëve brenda familjeve dhe komuniteteve, veçanërisht atyre më vulnerabel”.



Shërbyer 150 klienteve nga grupe vulnerabël

Komunitetet “Rom” dhe “Egjiptian” janë grupet më të nënshërbyera në Shqipëri, nisur nga kjo suportimi i tyre ka qenë gjithmonë në fokus të drejtëpërdrejtë të Agro & Social Fund aktivitetin e tyre.



Shërbyer 1,005 klienteve femra

Ne besojmë se ndihma që i jepet një gruaje reflekton më shpejt në mirëqenien në tërësi të familjes. Në Shqipëri gratë kanë shumë më pak mundësi ekonomike, siguri dhe liri. Ne mbështesim gratë për të zhvilluar aftësitë profesionale, për të filluar bizneset e tyre, si dhe për të investuar në mirëqenien e familjeve të tyre.



Shërbyer 808 klienteve rural

Suportimi i klientëve në zona rurale për të rritur aktivitetin e tyre bujqësor/blegtoral është një mënyrë efektive për të luftuar varferinë. Përkrahja e tyre për të rritur fitimet nga shitja e prodhimeve është një mjet i qënësishëm në zhvillimin e këtyre zonave, të cilat lihen, relativisht, ne harresë nga institucionet financiare.



Shërbyer 1,011 klienteve për edukim/shëndetësi

Kredia Sociale synon të sigurojë një mundësi për studentët që jetojnë në zonat rurale për të fituar qasje në shërbime arsimore, duke mbështetur ëndrrën e një studenti për tu arsimuar, dhe për të përmirësuar perspektivat e tyre të ardhshme të punësimit.

Ndërkohë që ndihmoni familjet të mund të paguajnë për ilaçet, operacionet dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor që ju duhen.

Projekte

Agro & Social Fund është në kërkim të vazhdueshëm të projekteve që mund të ndihmojnë institucionin në arritjen e një performance efektive dhe eficiente; si edhe partnerëve që mund të zgjerojnë impaktin tonë dhe operimin konform rregullave ndërkombëtare.

Kiva:



Kiva është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse, e themeluar në vitin 2005 me mision për të lidhur e afruar njerëzit nëpërmjet huadhënies dhe për të lehtësuar varfërinë. Kiva synon të ofrojë mundësi për huamarrës në gjithë botën, veçanërisht vendet në zhvillim, përfshirë Shqipërinë.

ASF dhe Kiva gjatë 2019:

503 – kredi të financuara në Kiva te cilat ndihmojnë njerëzit të krijojnë mundësi për vete dhe komunitet ku jetojnë

\$695,400 – financime në kiva për të ndihmuar njerëzit të përmirësojnë jetën e tyre dhe të familjeve të tyre.

60 financime për rritjen e nivelit të edukimit

230 kredi për forcimin dhe zhvillimin e figurës së femrës

Dorcas Aid International



Programi tre vjeçar “NXITJA E SIPËRMARRJES NË RAJONIN E TROPOJËS NËPËRMJET KREDITIMIT” me partnerë DORCAS ALBANIA, Agro & Social Fund dhe Shoqata “Integrim Tropoja” filloi zbatimin e tij në muajin Prill 2019 në zonën e Tropojës. Lidhur me të gjitha fushat e ndërhyrjes do të jenë prioritare promovimi i rolit ekonomik të grave, barazia gjinore, fuqizimi i grave dhe avokimi për shërbimin e duhur publik.

Diakonia Agapes



Marrëveshja “PËR NXITJEN E SIPËRMARRJES NË RAJONIN E ELBASANIT NËPËRMJET KREDITIMIT”, ka si qëllim lehtësimin dhe ngritjen e një sistemi, që mundëson banorët e Njësi Administrative Gjinar, Shushicë dhe Tregan – Bashkia Elbasan të kenë më shumë akses ndaj mikrokredisë për investime në turizëm, bujqësi, shërbime.

Fushata Borrow Wisely / Huamarrje e Zgjuar.

Gjatë muajit Tetor 2019 Agro & Social Fund ju bashkua fushatës sensibilizuese dhe edukuese "Borrow Wisely", një fushatë mbarë europiane dedikuar edukimit,

ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të njohurive financiare të klientëve, si edhe aftësive të tyre për menaxhim të shëndetshëm të ekonomisë familjare.

Fushatë mbarë europiane dedikuar edukimit, ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të njohurive financiare të klientëve.



Aftësimin e pjesëmarrësve për menaxhim të shëndetshëm të ekonomisë familjare

Qasja e Fushatës
Fushata në Universitete
SMS Klientëve
Prezantime të tjera:
peer of peer,
ditë tregu, etj.

Tetor 2020
Agro & Social Fund ka konfirmuar pjesëmarrjen edhe për fushatën e këtij viti.





Arta Hoxhalli

Klientja Arta Hoxhalli është një ndër klientet më besnike dhe më të hershme të Agro & Social Fund. Ajo ka marr kredinë e parë në vitin 2004, kur fëmijët e saj ishin ende në një moshë të vogël. Ndërkohë që kredinë e saj të 11-të në Agro & Social Fund e mori në vitin 2019. “ 11 kredi mund të duken shumë për këdo, por për mua dhe për familjen time nuk kanë qenë asnjëherë të tepërta, pasi në saj të tyre ne kemi mundur të zhvillojmë aktivitetin tonë bujqësor, të përmirësojmë kushtet e banimit dhe njëkohësisht të paguajmë për shkollimin e 3 djemve tanë!”- është shprehur Arta, gjatë një interviste, kur u pyet për numrin e lartë të kredive që ka patur ndër vite. Arta është një ndër klientët që ka shoqëruar zhvillimin tone. Bashkë me ne janë rritur fëmijët e Artës dhe mirëqenia e familjes së saj.

Arta është një zonjë e martuar dhe nënë e 3 djemve, me të madhin 27 vjeç dhe dy binjakët 23 vjeç. Arta me familjen e saj jetojnë në fshatin Vashtëmi, të qytetit të Korçës. Aktiviteti i tyre kryesor është bujqësia. Arta së bashku me familjen mbjellin perime të ndryshme, nga ato më tipiket për rajonin e Korçës, si fasule, patate, qepë dhe specia, deri te ato më jo-tipike dhe më pak të njohura për zonat e tjera, si lule cjanë ...

Hyrmet Demushi është një ndër klientët që u financua nga projekti që Agro & Social Fund, në bashkëpunim me Dorcas Albania dhe Integrimi Tropoja, ka në rajonin e Tropojës. Hyrmeti është një njeri me zemër të madhe dhe tipik mikëpritës i zonës së veriut të Shqipërisë. Dashurinë që ka për vendin e tij ja ka ngulitur edhe fëmijëve të tij, të cilët pamvarësisht shkollimit Universitar dhe pas Universitar kanë zgjedhur të qëndrojnë përkrah Hyrmetit në Valbonë dhe të zhvillojnë “guest house” e tyre.

Hyrmet Demushi



Siç mund të vihet re nga fotot, me një financim prej 400,000 lekë dhe me shumë përkushtim nga ana e të gjithë familjes, ata kanë arritur që të shndërrojnë materiale të papërpunuar në një ndërtesë të përfunduar, duke përdorur elemente të natyrës vendase, si guri dhe druri.


Ju ftojme të gjithëve ta vizitoni në skajin më verior të Valbonës. Mjafton të pyesni, gjithëkush e njih dhe do të ketë dashamirësinë t’ju drejtoj drejt “guest house” të tij.



Partnerët Tanë



NA NDIQNI NË RRJETET TONA SOCIALE





Adresa: Rr. "Nikolla Lena", Hyrja 1, Ap. 25, Tiranë
www.asf.al